



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2044/8 prot.

Datë 13.08.2024

V E N D I M
Nr. 1040/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.08.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-06678-05-27-2024, me objekt Loti 2: “Blerje fruta dhe perime” me fond limit 21,514,091.65 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier

Ankimues: Operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK, me NIPT J64103483H. Adresa Lagjja “Karbunarë e Poshtme”, Rr e Beratit, Km 1, Magazinë 2 kate, Nr. Pasurie 652/132, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.
Adresa: Lagjja “29 Nëntori”, Rruga “Kastriot Muço”, Fier

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Nelsa” SHPK, me NIPT J71601012S dhe adresë Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.05.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-06678-05-27-2024,

me objekt Loti 2: “Blerje fruta dhe perime” me fond limit 21,514,091.65 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.

II.2. Në datë 27.06.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 12.07.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- “ SINANI TRADING” SHPK	14 733 169 lekë	skualifikuar
- “NELSA” SHPK	16 157 248 lekë	kualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK është njoftuar për arsyen e skualifikimit të ofertës së tij si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik Sinani Trading SHPK rezulton të ketë ofertuar në dy lote.

Konkretisht:

-Loti 2: “Blerje fruta dhe perime” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se 8 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 2), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

-Loti 4: “Blerje ushqime koloniale” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se 4 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 4), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

Në përmbushje të këtij kriteri OE Sinani Trading SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlere e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar.

• Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, në pikën 2.3.3 kërkohe: ” Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje dokument për pronësi (vërtetuar me aktin e pronësisë kopje e noterizuar) ose me qera ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, te ambjenteve të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi e pajisur me leje higjeno-sanitare lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas

procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.”

Në përmbushje të këtij kriteri OE nuk ka deklaruar një ambjent për tregëtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi, siç është kërkuar në pikë 2.3.3.

II.5. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me 18.07.2027 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak.

II.6. Në datën 23.07.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4362, datë 23.07.2024 dhe me Nr. 2044/2024 Prot., date 23.07.2024 e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2044/2 prot., datë 24.07.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Sinani Trading” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi konkretisht duke pretenduar: “Pasi u njohem me arsyet e refuzimit te ofertes sone, gjykojme qe jane te pabazuara, diskriminuese dhe bien ndesh me kerkesat qe vete AK ka kerkuar ne DST. Ne lidhje me piken 2.3.1 per pervojen e meparshme kemi paraqitur faturat si me poshte:

Nr.dhe Data Fatures Vlera pa TVSH

59/2021 date 10.08.2021 xxx

119/2021 date 10.09.2021 xxx

181/2021 date 12.10.2021 xxx

237/2021 date 12.11.2021 xxx

Vlera Totale pa TVSH xxx

Sic shihet nga faturat e paraqitura nga ana jone, vlera e tyre e arrin dhe e tejkalon vleren prej 8.000.000 leke pa tvsh te kerkuar nga AK. Keto fatura jane paraqitur vetem ne lotin objekt ankese (Loti “Blerje Fruta dhe Perime”), dhe jo ne lotin tjeter ku kemi ofertuar.

Ne lidhje me piken 2.3.3 AK kerkon nje dokument per pronesi (vertetuar me aktin e pronesise kopje e noterizuar) ose me qera ose ne perdorim kundrejt kontratave perkatese te noterizuara, te ambjenteve te pershtatshme per tregtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi e pajisur me leje higjeno-sanitare leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. Per plotesimin e ketij kushti eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojces Nr.8(Formulari Permbledhes i Vetdeklarimit). Pra, sic shihet dhe nga kerkesa me siper, AK per

plotesimin e ketij kushti thote qe eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojces Nr.8(Formulari Permbledhes i Vetdeklarimit), shtojce qe eshte miratuar nga APP dhe qe eshte vendosur ne DST nga vet Autoriteti Kontraktor. Kerkesa me siper eshte mese e qarte dhe nuk le vend per interpretime pasi thuhet qartazi (Sipas Shtojces Nr.8), dhe jo sipas ndonje formati tjetër. Ne kemi paraqitur formularin sipas Shtojces Nr.8, dhe nuk mund te shtojme dhe as te pakesojme asgje jashte ketij formati. Per me teper, AK ne cdo mund te kerkoj informacion ne lidhje me vetdeklarimin dhe disponimin e ambientit te kerkuar me siper. Pra, ky pretendim bie ndesh me kerkesen qe vet AK ka kerkuar per permbushjen e ketij kriteri. Sa më sipër argumentuam, kërkohmë kualifikimin e ofertës sonë, pasi është refuzuar në mënyrë të padrejtë, diskriminuose, në kundërshtim me ligjet në fuqi, madje edhe me vetë kërkesat që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar.”

II.8. Me datë 29.07.2024 operatori ekonomik “Nelsa” SHPK ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike formularin e paraqitjes së argumentave në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së i cili u protokollua me tonën me nr.2044/3 prot., datë 29.07.2024.

II.9. Me datë 02.08.2024 autoriteti kontraktor ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike shkresën nr. 411/46 prot., datë 01.08.2024 protokolluar me tonën me nr. 2044/4 prot., datë 02.08.2024, bashkëlidhur së cilës gjendet vendimi nr. 411/42 datë 01.08.2024 i KSHA nga ku rezulton, se ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes duke argumentuar: “Referuar formulari të ankesës së bërë nga operatori Sinani Trading SHPK subjekti ankimes pretendon se: “Në lidhje me pretendimin e ankimesit SINANI TRADING SHPK, komisioni i ngritur për shqyrtimin e kësaj anese arsyeton si më poshtë vijon:

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentave të vëna në dispozicion nga Njësia e Prokurimit, dokumentave të hedhura në sistem prej operatoreve ekonomik, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të dosjes së tenderit, konstatoi se:

Referuar specifikimeve teknike të kërkuara nga AK dhe shtojcës 8 të DST-së konkretisht LOTI 2: “Blerje Fruta dhe Perime” pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, nënpika 2.3.3, ku përcaktohet se:)2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje dokumenti për pronësi (vërtetuar me aktin e pronësisë kopje e noterizuar) ose me qera ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, te ambjenteve të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi e pajisur me leje higjeno-sanitare lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne Perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar”

Pra, sa më sipër kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë ne shtojcës nr.8 formulari përmbledhës i vetëdeklarimit) ambjente për tregëtimin dhe magazinimin e produkteve ushqimore koloniale objekt prokurimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE dhe shtojces 8 te paraqitur nga OE verehet se per përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik nuk ka dektuar, ne shtojcës nr.8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, asnje ambjente për tregëtunin dhe magazinimin e produkteve Ushqimore fruta perime objekt prokurimi.

Kështu që pretendimi i OE për përmbushjen e këtij kriteri se c ka plotesuar me paraqitjen e shtojces 8 nuk qëndron, pasi nuk e ka deklaruar ambjentin ne shtojcen 8. (bashkengjitur formulari përmbledhës i vetedeklarimit.)

Referuar Shtojcës 7 të DST-së përcaktohet se “Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat konkurrojnë per me shumë se nje lot, duket te plotesojne kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë konkretisht LOTI 2: “Blerje Fruta dhe Perime”

Operatori ekonomik Sinani Trading SHPK rezulton të ketë ofertuar në 2 lote. Konkretisht:

“Loti 2: “Blerje fruta dhe perime” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 8 000 000 leke pa TVSH te cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40”o të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet për Lotin 2), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

“Loti 4: “Blerje ushqime koloniale” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet. “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 4 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40”o të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet — për Lotin 4), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

Detyrimi sipas shënimit të DST citon se: “Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat konkurrojnë per me shumë se nje lot, duhet te plotesojne kriteret e veçanta,xhiron vjetore sipas pikes 2.2.1., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.”, pra vlera e pervojes se ngjashme qe duhet të ngarkonte ne sistem duhet te ishte 12,000,000 (dymbëdhjetë million) leke pa tvsh e cila është vlera e shumës së loteve ku OE ka marre pjese, ndërkohë QE “Sinani Trading” SHPK, ka ngarkuar si dokumentacion në sistem faturat në vlerën totale xxx lekë pa TVSH.

Kështu që pretendimi i OE për përmbushjen e këtij kriteri se e ka plotesuar me paraqitjen e faturave të veçanta që e përmbushin dhe e tejkalojnë disa herë herë vlerën e kërkuar nga AK nuk qëndron. Në përmbushje të këtij kriteri OE Sinani Trading SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlera e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik SINANI TRADING SHPK nuk qëndron.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe rrethanave të saj, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi analizoi pretendimet e ankimesit të parashtruara në ankesë, pasi u konsultua me dispozitat e ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, gjykon se pretendimet e subjektit ankimes nuk qëndrojnë, pasi nuk gjejnë mbështetje në fakte, në prova, në

ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në DST.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 dhe 4 të ligjit nr.16272020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenit 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,

Vendos:

- 1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik SINANI TRADING SHPK, për procedurën e prokurimit publik me objekt “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, e ndare ne 5 Lote, - Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues per secilin Lot, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj” Loti 2: “Blerje Fruta dhe Perime”, me nr. REF06678-05-27-2024, me fond limit prej 21 514 091,65 (njëzet e një milion e pesëqind e katërbëdhjetë mijë e zero nëntëdhjetë e një presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 27.06.2024, nga Autoriteti Kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.*
- 2. Autoriteti Kontraktor të njoftojë subjektin ankimues, subjektet e interesuara dhe KPP, duke i komunikuar me shkrim këtë vendim, në përputhje me rregullat e prokurimit dhe Udhëzimet e APP-së.*
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik. 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

II.10. Informacionin më sipër mbi trajtimin e ankesës së autoritetit kontraktor e ka dërguar edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr.2044/5 prot., datë 02.08.2024.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton;

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Sinani Trading” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: • *Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, në pikën 2.3.3 kërkohet: ” Operatori ekonomik duhet të paraqesë nje dokument për pronësi (vërtetuar me aktin e pronësisë kopje e noterizuar) ose me qera ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara, te ambjenteve të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi e pajisur me leje higjeno-sanitare lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.*

Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.”

Në përmbushje të këtij kriteri OE nuk ka deklaruar një ambjent për tregëtimin dhe magazinimin e fruta dhe perimeve objekt prokurimi, siç është kërkuar në pikë 2.3.3.”,

Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor, gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK,, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe konkretisht:

III.1.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, loti 2. “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument ne pronësi (vërtetuar me aktin e pronësisë ose kopje e noterizuar), ose me qera, ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara te shoqeruara me dokumentacionin e vertetimit te pronësisë, te ambjenteve të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e produkteve ushqimore koloniale objekt prokurimi, te pajisur me leje higjeno-sanitare lëshuar nga organet kompetente te ngarkuara me ligj.*

Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar

Ndërsa në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	----- -----
Numri NIPT/et:	----- -----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	----- -----
Telefoni:	----- -----
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIP - i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekt eve	N I P T - i	Lloji i kapaciteti t për të cilin do të mbështete t operatori ekonomik	Specifiko konkretish t kapacitetin /et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1.Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
- 2.Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
- 3.Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
- 4.Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5.Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

- a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
- b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6.Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7.Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9.Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë

qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu</p>

të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë

se:
<ul style="list-style-type: none"> • Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. • Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. • Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim	Po [] Jo []

<p>përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</p>	
--	--

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <p>_____</p> <p>Profili i punonjësve</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <p>_____</p>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

III.1.3. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- *Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK*

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5 Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar “ Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” parashikohet :

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastiit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyetimin se nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit lidhur me ambientin për tregëtimin dhe magazinimin e fruta perimeve objekt prokurimi, siç është kërkuar në pikën 2.3.3 KPP vëren, se në kriterin e veçantë të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument ne pronësi (vërtetuar me aktin e pronësisë ose kopje e noterizuar), ose me qera, ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara te shoqeruara me dokumentacionin e vertetimit te pronësisë, te ambjenteve të përshtatshme për tregëtimin dhe magazinimin e produkteve ushqimore koloniale objekt prokurimi, te pajisur me leje higjeno-sanitare lëshuar nga organet kompetente te ngarkuara me ligj.

Per plotesimin e ketij kushti është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari pas procesit te vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e plotë prane AK ne perputhje me nenin 26, pika 6, paragrafi 1, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë për përmbushjen e kriterit më sipër, si dhe arsyeve të skualifikimit të dhëna nga autoriteti kontraktor,

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri në fjalë i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me disponimin e ambienteve për tregëtimin dhe magazinimin e mallrave objekt prokurimi, kriter i cili plotësohet me paraqitjen e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit), është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo.

Referuar parashikimeve të nenit 82 të *lex specialis* si dhe nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, janë përcaktuar kriteret e kualifikimit të cilat plotësohen me formularin e vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga verifikimet rezulton, se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me deklarimin në formularin e vetëdeklarimit të një ambjenti për tregëtimin dhe magazinimin e produkteve fruta perime objekt prokurimi në njërin nga format e kërkuara nga autoriteti kontraktor (në pronësi/me qera/në përdorim), nuk është në përputhje me nenin 82 të LPP dhe nenin 26, pika 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, pasi nuk përfshihet në asnjërin prej rubrikave të formularit të vetëdeklarimit. Në bazën ligjore të sipërcituar përcaktohet qartë se cilat janë kriteret e kualifikimit të cilat plotësohen me formularin e vetëdeklarimit.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi, si dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë, parashikimet e 82 të LPP dhe nenit 26, pika 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishe për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë autoriteti kontraktor ka hartuar një kriter në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimesit, nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e kërkesave, duke qenë se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me disponimin e ambjentit për tregëtimin dhe

magazinimin e produkteve fruta perime objekt prokurimi, në njërin nga format e kërkuara nga autoriteti kontraktor (në pronësi/me qera/në përdorim), nëpërmjet deklaratimit në formularin të vetdeklarimit është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave, si dhe në vlerësimin e tyre. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta, të sakta nga autoriteti kontraktor si dhe me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik dhe atë sektorial në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.9. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe kjo përbën shkak për anulimin pjesërisht të dokumenteve të tenderit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kritere jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Sinani Trading” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se:

- Operatori ekonomik Sinani Trading SHPK rezulton të ketë ofertuar në dy lote.

Konkretisht:

-Loti 2: *“Blerje fruta dhe perime” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kerkuar është jo më pak se 8 000 000 leke pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 2), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”*

-Loti 4: *“Blerje ushqime koloniale” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve*

të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 4 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 4), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

Në përmbushje të këtij kriteri OE Sinani Trading SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlera e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar.” KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, loti 2. “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **8 000 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – **për Lotin 2**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, loti 2. “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kërkesa si më poshtë:

Shënim: Operoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojne per me shumë se nje lot, duhet te plotesojne kriteret e veçanta,xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojne.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK në përmbushje të kriterit dhe të kërkesës më sipër ka dorëzuar faturat si më poshtë:

Nr.Faturës	Data Fatures	Vlera pa TVSH
59/2021	10.08.2021	xxx lekë
119/2021	10.09.2021	xxx lekë
181/2021	12.10.2021	xxx lekë

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.2.6. Neni 39 “Ndarja e kontratave në lote”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.2.7. Në nenin 40 pika 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.2.8. Në nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t’i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t’i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.”

III.2.9 . Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që

nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi konstaton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu nga verifikimi i loteve të publikuara, baza e të dhënave të ankesave si dhe raporti i auditit në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Sinani Trading” SHPK është ofertues në Lotin II dhe në Lotin IV, njëkohësisht dhe ankimues për të dy lotet. Nga ky verifikim Komisioni arrin në konkluzion, se siç u theksua më sipër operatori ekonomik ankimues është ofertues në dy lote (loti II dhe IV), ku arsyeja e skualifikimit për lotin II është: “- Operatori ekonomik Sinani Trading SHPK rezulton të ketë ofertuar në dy lote.

Konkretisht:

-Loti 2: “Blerje fruta dhe perime” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se 8 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 2), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

-Loti 4: “Blerje ushqime koloniale” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se 4 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 4), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.”

Në përbushje të këtij kriteri OE Sinani Trading SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlere e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar.”. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi në sistemin e prokurimeve elektronike, por edhe kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor dhe përbajtjes së ankesës rezulton se operatori ekonomik ankimues “Sinani Trading” SHPK ka ofertuar dhe dorëzuar si dokumentacion në

përmbushje të kriterit dhe kërkesës më sipër të autoritetit kontraktor faturat e cituara në pikën III.2.3. të këtij vendimi ku rezulton se vlera në total e tyre për lotin 2 është xxx lekë pa TVSH. Autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit pika 2.3.1 e kriterëve të veçanta të kualifikimit për lotin II dhe IV respektivisht ka përcaktuar që për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe vlera e kërkuar është jo më pak se 8 000 000 leke pa TVSH (për lotin II) dhe jo më pak se 4 000 000 lekë pa TVSH (për lotin IV). Nga ana tjetër gjithashtu ka kërkuar që: ***“Shënim: Operatoret ekonomike të cilët do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për më shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe përvojën e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.”*** Referuar hartimit të kriterit të vecantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 për kontratat e ngjashme dhe vlerës së kërkuar për lotet ku ankimesi ka paraqitur ofertën e tij (për lotin II vlera e kërkuar është jo më pak se 8 000 000 leke pa TVSH dhe për lotin IV jo më pak se 4 000 000 lekë pa TVSH), si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë të cilët do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për më shumë se një lot, duhet të plotësojnë përvojën e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurojnë, vlera e faturave të paraqitura nga ankimesi për lotin II objekt ankimi si dëshmi e shërbimeve të ngjashme të kryera brenda tre viteve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës duhet të jo më pak se shuma e vlerës së kontratave të ngjashme të kërkuar për lotin II dhe për lotin IV ku ankimesi është ofertues, të marra së bashku, pra jo më pak se 12 000 000 lekë pa TVSH. Ndërkohë nga verifikimi i vlerës së faturave të paraqitura nga ankimesi në SPE për lotin II në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 sipas kërkesës më sipër të autoritetit kontraktor është xxx lekë pa TVSH, ndërsa për lotin 4 është në vlerën xxx, pra më shumë se 12 000 000 lekë pa TVSH, si shumë e lotit II dhe IV, e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Vlen të theksojmë se faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimesi janë të ndryshme për lotet në të cilat ka konkuruar.

Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK është në kushtet e përmbushjes së pikës 2.3.1 të kriterëve të vecanta të kualifikimit lidhur me furnizimet e mëparshme të ngjashme sipas kërkesës së përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se **“Operatoret ekonomike të cilët do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për më shumë se një lot, duhet të plotësojnë përvojën e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.”** KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ankimesit e ka bërë jo në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke skualifikuar në këtë mënyrë operatorin ekonomik ankimesi i cili disponon dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor. Për sa kohë që operatori ekonomik ankimesi është ofertues në dy lote (loti II dhe loti II) dhe për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme me vlerë jo më pak se shuma e loteve në të cilat ka konkuruar, pra jo më pak se 12 000 000 lekë pa TVSH, kriteri konsiderohet i përmbushur. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga ankimesi në përmbushje të këtij kriteri kualifikimi rezulton se dëshmitë për furnizimet e ngjashme për të dy lotet janë në vlerën xxx lekë, duke përmbushur dhe tejkaluar vlerën 12, 000, 000 lekë pa tvsh të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Sa më sipër, KPP vlerëson, se operatori ekonomik ankimesi ka arritur që të dorëzojë

dëshmi që ka realizuar furnizime të ngjashme në vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues arrin të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-06678-05-27-2024, me objekt Loti 2: “Blerje fruta dhe perime” me fond limit 21,514,091.65 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës, të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

